



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/
OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION

THIRRJE PËR APLIKIM
PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË "PLANIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2007-13", MBËSHTETJE PËR INVESTIME NË MASËN 2 »RISTRUKTURIMI I POTENCIALIT FIZIK NË SEKTORIN AGRO-RURAL« PËR NËN-MASËN 3, 4 & 5 PËR »SEKTORIN E PEMËTARISË, PERIMTARISË DHE VRESHTARISË«

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare/granteve për investime në ferma, në kuadër të Masës 2 »Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin agro-rural« sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007-2013, për nën-masën 2 për »Sektorin e pemëtarisë, perimekulturës dhe vreshtarisë«.

II. Përfituesit e pranueshëm

Përfituesit e pranueshëm për këtë nën-masë janë personat fizik dhe juridik. Ata duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës (personat fizik) ose të jenë të regjistruar në regjistrin e biznesit në Kosovë (personat juridik), ata duhet t'i përmbushin kushtet sipas kësaj thirrje për aplikim.

III. Investimet e pranueshme

III.1. Lloji i investimeve të pranueshme për sektorin e pemëtarisë

- ↳ Ngritja e pemishteve të reja me kulturën e mollës për prodhim intensiv me infrastrukturë përcjellëse, konform investimeve që fermeri realizon (sistemi i ujitjes pikë-pikë, sistemi i mbajtjes dhe rrethoja);
- ↳ Përfituesi, parcelën të cilën planifikon ta ngritë pemishten e re intensive duhet të ketë të siguruar burimin e ujit (pusin, rezervarin apo forma tjera të ndryshme);
- ↳ Investimet në infrastrukturën e fidanishteve për prodhimtarinë intensive të fidanëve (p.sh. rrethoja dhe sistemi i ujitjes pikë-pikë tek fidanishtet ekzistuese);
- ↳ Sistemi mbajtës duhet të jetë me shtylla të betonit, vendosja e shtyllave të betonit duhet të jetë në largësi 7 m (maksimumi 450 shtylla/ha), teli i zinkuar të vendoset në tri fije (tri rende të telit të zinkuar);
- ↳ Rrethoja mund të jetë me shtylla të betonit ose të metaltë, largësia në mes të shtyllave 2 m, lartësia e shtyllave 1.5 m, dimensionin e shtyllave të metalta,

- minimumi duhet të jetë Ø 4X4, profili i trashësisë së gypave minimumi 2 mm, lartësia e rrjetës së telit duhet të jetë 1.5 m dhe të jenë të ngjyrosur, maksimumi 450 shtylla;
- ↪ Investimet në infrastrukturën e pemishteve ekzistuese (për të gjitha llojet e pemëve) jo më të vjetra se tre vite (p.sh. sistemi i ujitjes, sistemi mbajtës dhe rrethoja e pemishtes);
- ↪ Sistemi i mbrojtjes nga breshri për pemishtet mbi dyvjeçare;
- ↪ Sistemi i mbrojtjes nga breshëri (rrjetat), investim i pranueshëm 1-2 ha;
- ↪ Pajisje për spërkatjen e pemëve, atomizerë mbajtës, makina për mullqerim, mekanizmi për përgatitjen e leheve dhe shtrirjen e folis dhe sistemit të ujitjes për kulturën e dredhëzës dhe mekanizëm për plehërim.

III 1.1. Mbjellja e pemëve të imëta (dredhëz, mjedër dhe manaferrë).

III.2. Lloji i investimeve të pranueshme për sektorin e perimtarisë

- ↪ Ndërtimi i serrave të reja;
- ↪ Zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese me serra të reja;
- ↪ Tipet e serave të cilat mbështeten (përkrahen) janë:
 - Serrat e tipit "tunel" ose bllok nga polietileni, sipërfaqja prej 500 m²;
 - Serrat e tipit "bllok" nga polietileni, sipërfaqja prej 500 - 1000 m²;

III.2.1. Blerja e makinerisë së specializuar bujqësore për kultivimin e perimeve në fushë të hapur si:

- ↪ Makinaria për përgatitjen e shtretërve për qepë dhe karrota;
- ↪ Makinaria për mbjelljen e qepës dhe karrotës me farë;
- ↪ Makinaria për shtrirjen e plastmastit të zi;
- ↪ Makinë për nxjerrjen e qepëve;
- ↪ Makinë për nxjerrjen e karrotave.

III.3. Lloji i investimeve të pranueshme për sektorin e vreshtarisë

- ↪ Ngritja e vreshtave të reja për rrush të tryezës 0.50 ha deri 2.0 ha;
- ↪ Ngritja e vreshtit të ri të bëhet me material fidanor i cili i plotëson të gjitha standardet e parapara sipas Ligji për materialin fidanor, Nr. 2004/13 të datës 28.05.2004, pas marrjes së letrës informuese;
- ↪ Investimet në infrastrukturën e vreshtave ekzistuese për të gjitha llojet e vreshtave (p.sh. sistemi mbajtës dhe rrethoja e vreshtit) në vreshtat e reja jo më të vjetra se dy vite;
- ↪ Pajisje për spërkatje të vreshtave, atomizerë bartës, makina për mullqerim dhe mekanizëm për plehërim.

IV. Kriteret e pranueshme

Kriteret e përgjithshme të pranueshme duhet të plotësohen kur të jetë dorëzuar kërkesa.

IV.1. Kriteret e përgjithshme të pranueshme

- ↪ Përfituesit duhet të dorëzojnë kërkesën e plotësuar në formularin për aplikim, së bashku me dokumentet e bashkangjitura të vlefshëm (Shtojca 1);
- ↪ Përfituesit duhet të dëshmojnë se kanë vijuar trajnime relevante/specifike ose të obligohen në formë të shkruar që të vijojnë trajnimet përkatëse brenda afatit të përmbylljes së projektit;
- ↪ Përfituesit duhet të kenë të hapur llogari bankare në Republikën e Kosovës;
- ↪ Toka në përdorim duhet të jetë në pronësi të përfituesve ose në rast të fermave familjare të kontraktuara për shfrytëzim për së paku për 3 vitet e ardhshme pas dorëzimit të aplikacionit. Në rast të fermave familjare, pronari i tokës mund të jetë fermeri ose të afërmit e tij/saj.

IV.2. Kriteret specifike sipas sektorit përkatës

a) Sektori i pemëtarisë:

- ↪ Fermerët duhet të dëshmojnë se posedojnë tokë bujqësore, toka mund të jetë në pronësi të fermerit ose e kontraktuar për shfrytëzim;
- ↪ Fermerët duhet të ngrisin së paku 0,50 ha deri 3 ha pemishte të reja me mollë;
- ↪ Sipërfaqja minimale e secilës ngastër (pemishtet e reja që ngriten me mollë) duhet të jetë 0,50 ha e pandarë;
- ↪ Fermerët duhet të ngrisin së paku 10 deri 20 ari me pemë të imëta (dredhëz, mjedër dhe manaferrë);
- ↪ Përfitues do të jenë vetëm ata fermerë që ngrisin pemishte të reja (intensive) me mbjellje të dendur me mbi 1600 fidane/ha;
- ↪ Ngritja e pemishteve të reja me kulturën e mollës të bëhet me material fidanor i cili i plotëson të gjitha standardet e parapara sipas Ligjit për materialin fidanor Nr. 2004/13 të datës 28.05.2004;
- ↪ Ngritja e pemishteve të reja, me kulturën e mollës, me material fidanor të kategorisë së certifikuar, do të kenë përparësi;
- ↪ Përfituesit duhet të dëshmojnë me anë të dokumentacionit se janë furnizuar me material fidanor të mollës nga kompania (subjekti) që është i licencuar si prodhues i materialit fidanor të pemëve nga MBPZHR-DPMB;
- ↪ Materiali fidanor i importuar duhet të posedoj dëshminë mbi gjendjen shëndetësore (certifikatën fitosanitare);
- ↪ Përfituesit që ngrisin pemishte të reja me kulturën e mollës, për materialin fidanor të mbjellur, duhet të posedojnë dëshmi për gjendjen shëndetësore dhe pastërtinë varietore;
- ↪ Përfituesit që ngrisin pemishte të reja me kulturën e mollës duhet të kenë kopje të planit (për investimin e bërë, ngritjen e pemishtes apo serrës), fotokopje;
- ↪ Kultivarët e pranueshme të mollës:

Kultivari	Nënshartesa
a) Granny Smith -----	M 9
b) Fuji -----	M 9

- c) Gala (Royal, Mondial) -----M 9
- d) Delishes i kuq ----- M 9
- e) Delishes i artë (Kloni B)----- M 9
- f) Red Falstaf ----- M 9
- g) Mutsu ----- M 9
- h) Jonagored ----- M 9
- i) Glloster -----M 9
- j) Brauburn-----M 9
- k) Jonagold-----M 9
- l) Elstar-----M 9
- m) Saturn-----M 9

- ☞ Përfituesit duhet të dëshmojnë se do të ngrisin së paku 0,5 hektarë pemishte të re me mollë. Ndërsa, përfituesit e pemëve të imta duhet të ngrisin së paku 10 deri 20 ari me pemë të imëta (dredhëz, mjedër dhe manaferrë);
- ☞ Tërë territori i Republikës së Kosovës është i pranueshëm për aplikim (i plotëson kushtet).

b) Sektori i perimtarisë

- ☞ Fermerët duhet të posedojnë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës bujqësore;
- ☞ Toka mund të jetë në pronësi të fermerit ose e kontraktuar për shfrytëzim;
- ☞ Fermerët duhet të investojnë në ngritjen (ndërtimin) e serrave të reja në një sipërfaqe prej 500 m² deri 1000 m²;
- ☞ Fermerët mund të rrisin kapacitetet me serra të reja në një sipërfaqe prej 500 m² deri 1000 m²;
- ☞ Në rastin e blerjes të serrave të tipit 'tunel' është e pranueshme vetëm serra e tipit 'tunel' nga polietileni, me dimensione së paku 8 x 62 x 4 = 496 m²;
- ☞ Në rast të blerjes të serrave të tipit 'bllok' është e pranueshëm vetëm serra e tipit 'bllok' nga polietileni;
- ☞ Kushtet specifike për ndërtimin e serrave të reja me nivelin mesatar teknologjik: Serrat të jenë zhvendosëse.

Hapja e themeleve duhet të jetë 60 x 60 x 45 cm

- Bazamenti duhet të jetë bërë nga shputa betoni dhe me një gyp (të diametrit Ø 6/4) i cili duhet vendosur në mes;
- Bazamenti duhet të jetë i ndërtuar me gypa të zinkuar (me diametër Ø 5/4) gjatësia 2,4 m;
- Mbushja e kapriateve (harku me perforues) duhet të jetë me gypa të zinkuar (diametri Ø 3/4);
- Pjesa e poshtme e kapriateve duhet të jetë me gypa të zinkuar (të diametrit Ø 1);
- Harku i kapriateve duhet të jetë me gypa të zinkuar (të diametrit Ø 5/4);
- Brinaket duhet të jenë me gypa të zinkuar (të diametrit Ø 3/4);

- Shtangimet e ndërtimit (X-at) duhet të jenë me gypa të zinkuar (të diametrit Ø 3/4);
- Dyert duhet të jenë të vendosura në pjesën ballore;
- Sistemi i ajrosjes në mënyrë mekanike, hapja e dritareve bëhet mekanikisht përmes gypave të zinkuar (të diametrit Ø 1/2) dhe të sforcuar me kapëse PVC 1/2;
- Folia plastike duhet të jetë 160 µ (me garanci 3-5 vjet);
- Serrat që janë ndërtuar me materiale edhe më cilësore mund të jenë përfituese;
- Tërë territori i Republikës së Kosovës është i pranueshëm për aplikim (i plotëson kushtet).

c) Sektori i vreshtarisë:

- ↪ Fermerët duhet të dëshmojnë se posedojnë tokë bujqësore, toka mund të jetë në pronësi të fermerit ose e kontraktuar për shfrytëzim;
- ↪ Fermerët duhet të ngrisin së paku 0,50 ha deri 2 ha vreshta të reja për rrush të tryezës. Sipërfaqja minimale e secilës ngastër duhet të jetë 0,5 ha.
- ↪ Ngritja e vreshtit të ri të bëhet me material fidanor i cili i plotëson të gjitha standardet e parapara sipas Ligjit për materialin fidanor Nr. 2004/13 të datës 28.05.2004;
- ↪ Ngritja e vreshtit të ri me material fidanor të kategorisë së certifikuar do të kenë përparësi;
- ↪ Përfituesit duhet të dëshmojnë me anë të dokumentacionit se janë furnizuar me material fidanor të hardhisë së rrushit nga kompania (subjekti) që është i licencuar si prodhues i materialit fidanor të hardhisë së rrushit nga MBPZHR-DPMB;
- ↪ Materiali fidanor i importuar duhet të posedoj dëshminë mbi gjendjen shëndetësore (certifikatën fitosanitare);
- ↪ Përfituesit që mbjellin vreshta të reja, për materialin fidanor të mbjellura, duhet të posedojnë dëshmi për gjendjen shëndetësore dhe pastërtinë varietore;
- ↪ Numrin identifikues të fermerit-vreshtar, i cili nxirret në Entin e Vreshtarisë dhe të Verërave dhe dëshminë mbi shkëlqjen e vreshtave;
- ↪ Skica kadastrale e ngastres duhet të nxirret në Entin e Vreshtarisë në Rahovec;
- ↪ Regjionet e pranueshme për aplikim janë (shtrirja gjeografike):
Nën-regjioni jugor me vreshta: Rahovec, Prizren, Gjakovë, Suharekë, Malishevë.
Nën-regjioni verior me vreshta: Pejë, Istog, Klinë.

Kultivarët e pranueshme të hardhisë së rrushit:

- Kultivari Nënshartesa
- Muskat Hamburg-----Kober 5 bb, SO₄
- Victoria -----Kober 5 bb, SO₄

- Muskat Italian-----Kober 5 bb, SO₄
- Blek Maxhik-----Kober 5 bb, SO₄
- Kardinal-----Kober 5 bb, SO₄
- Demir Kapia -----Kober 5 bb, SO₄
- Afuz -ali-----Kober 5 bb, SO₄
- Matilda -----Kober 5 bb, SO₄
- Sultania -----Kober 5 bb, SO₄

V. Obligimet e përfituesve

- ↻ Projekti i miratuar duhet të ndërmerret në afat prej 2 muajsh, prej momentit të pranimit të letrës informuese për pranim të projektit;
- ↻ Fermat dhe aktivitetet e tyre duhet të jenë në përputhje me kërkesat sanitare, higjienike, si dhe me kërkesat dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me legjislacionin e tanishëm të Kosovës (pas përfundimit të projektit);
- ↻ Përfituesi duhet t'i lejojë kontrollet nga institucionet përkatëse;
- ↻ Përfituesi duhet të bëjë ri-imbursimin/kthimin e grantit të pranuar, nëse ai/ ajo nuk vepron në përputhje me secilin nga kushtet e mëposhtëm.

VI. Kostoja e pranueshme

VI.1. Shpenzimet e pranueshme janë:

- ↻ Shpenzimet e bëra për investime të pranueshme;
- ↻ Shpenzimet e bëra në përputhje me dispozitat e thirrjes së tanishme për aplikim;
- ↻ Shpenzimet e bëra pas marrjes së letrës informuese për miratim të projektit.

VI.2. Shpenzimet e papranueshme janë:

- ↻ Hapja e puseve, rezervuarëve, instalimi i rrymës;
- ↻ Serrat e tipit 'tunel' nuk pranohet të jenë të ndara, vetëm duhet të jenë një si tërësi;
- ↻ Taksat;
- ↻ Doganimit dhe obligimet e zhdoganimit nga importi, ose çfarëdo obligime tjera;
- ↻ Blerja, marrja me qira ose në shfrytëzim e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;
- ↻ Gjobat, gjobat financiare dhe shpenzimet e kontestit/procesit gjyqësor;
- ↻ Pajisjet e dorës së dytë (të përdorura);
- ↻ Shpenzimet bankare, shpenzimet e garancive dhe shpenzimet e ngjashme;
- ↻ Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes;
- ↻ Shpenzimet e bëra para marrjes së letrës informuese për miratim të projektit;
- ↻ Kontributi në mall.

VII. Dispozitat financiare

VII.1. Dispozitat financiare sipas sektorit:

a) Sektori pemëtarisë:

Intensiteti i ndihmave për sektorin e pemëtarisë për kulturën e mollës

Investimet e pranueshme: Minimumi i investimit 6000 € (për ngritjen e 0.50 ha pemishte). Shpenzimet e pranuar të projektit janë 50 % apo 3000 € për 0.50 ha pemishte.

Investimi për ngritjen e 1 ha pemishte me mollë është 12 000 €. Shpenzimet e pranuarat të projektit janë 50 % apo 6000 € për 1 ha pemishte me mollë.

Maksimumi i investimit është 36 000 € (për ngritjen e 3 ha me pemishte). Shpenzimet e pranuarat të projektit janë 50 % apo 18 000 € për 3 ha pemishte. Nëse kostoja është më e lartë se investimet e pranueshme, përfituesi duhet të sigurojë mjete financiare vetanake për të mbuluar koston e shpenzimeve.

Kufijtë më të ulët dhe më të lartë të shpenzimeve të koston së investimeve të pranueshme në infrastrukturën e pemishteve ekzistuese për të gjitha llojet e pemëve (jo më të vjetra se tri vite) janë më së paku 3000 € dhe më së shumti 6000 (për një ha). Nëse shpenzimet janë më të larta se 6000 € për një ha, atëherë përfituesi duhet të jap mjetet e veta financiare për të mbuluar këto shpenzime.

Investimi i pranueshëm për sistemin e mbrojtjes nga breshëri për një ha është minimumi 12 000 € apo 50% - 6000 € dhe maksimumi është 24 000 € për dy ha dhe 50% ose 12 000 €. Kufijtë më të ulët dhe më të lartë të shpenzimeve të investimeve të pranueshme në makineri janë më së paku 3000 € dhe më së shumti 6000 €. Nëse shpenzimet janë më të larta se 6000 €, atëherë përfituesi duhet të jap mjetet e veta financiare për të mbuluar këto shpenzime.

Intensiteti i ndihmave për sektorin e pemëtarisë për pemë të imta (dredhës, mjedër dhe manaferrë)

Investimet e pranueshme: Minimumi i investimit 2000 € (për ngritjen e 0.10 ha me kulturën e dredhës, mjedrës dhe manaferrës). Shpenzimet e pranuarat të projektit janë 50 % apo 1000 € për 0.10 ha. Maksimumi i investimit 4000 € (për ngritjen e 0.20 ha me kulturën e dredhës, mjedrës dhe manaferrës). Shpenzimet e pranuarat të projektit janë 50 % apo 2000 € për 0.20 ha. Nëse kostoja është më e lartë se investimet e pranueshme, përfituesi duhet të sigurojë mjete financiare vetanake për të mbuluar koston e shpenzimeve.

b) Sektori i perimtarisë:

Investimet e pranueshme për këtë nën-masë janë: a) minimumi i investimit 10 000 € për ngritjen e serrës prej 500 m². Shpenzimet e pranuarat të projektit janë 50 % apo 5000 € për 500 m² dhe b) maksimumi i investimit 20 000 € (për ngritjen e serrës prej 1000 m²). Shpenzimet e pranuarat të projektit janë 50% apo 10 000 € për 1000 m². Nëse kostoja është më e lartë se investimet e pranueshme, përfituesi duhet të sigurojë mjete financiare vetanake për të mbuluar koston e shpenzimeve.

Kufijtë më të ulët dhe të lartë të shpenzimeve të investimeve të pranueshme në makineri janë: më së paku 3000 € dhe më së shumti 6000 €. Nëse shpenzimet janë më të larta se 6000 €, atëherë përfituesi duhet të jap mjetet e veta financiare për të mbuluar këto shpenzime.

c) Sektori i vreshtarisë:

Investimet e pranueshme për këtë nën-masë janë: a) minimumi i investimit 4000 € (për ngritjen e 0.50 ha rrush tryeze). Shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 2000 € për 0.50 ha rrush tryeze. Investimi për ngritjen e 1 ha me vreshta për rrush tryeze është 8000 €. Shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 4000 € për 1 ha rrush tryeze dhe b) maksimumi i investimit 16 000 € (për ngritjen e 2 ha me vreshta, për rrush tryeze). Shpenzimet e pranuara të projektit janë 50 % apo 8000 € për 2 ha rrush tryeze. Nëse kostoja është më e lartë se investimet e pranueshme, përfituesi duhet të sigurojë mjete financiare vetanake për të mbuluar koston e shpenzimeve.

Kufijtë më të ulët dhe më të lartë të shpenzimeve të kostos së investimeve të pranueshme në infrastrukture të vreshtave ekzistuese jo më të vjetra se dy vite janë më së paku 2000 € dhe më së shumti 4000 € (për një ha). Nëse shpenzimet janë më të larta se 4000 € për një ha, atëherë përfituesi duhet të jap mjetet e veta financiare për të mbuluar këto shpenzime.

Kufijtë më të ulët dhe më të lartë të shpenzimeve të investimeve të pranueshme në makineri janë më së paku 3000 € dhe më së shumti 6000 €. Nëse shpenzimet janë më të larta se 6000 €, atëherë përfituesi duhet të jap mjetet e veta financiare për të mbuluar këto shpenzime.

VI. Koha dhe mënyra e pranimi të aplikacioneve

1. Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim;
2. Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë kalendarike nga data e publikimit. Procedimi i aplikacioneve do të bëhet sipas parimit të kriterëve të përzgjedhjes, të përcaktuara paraprakisht nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
3. Investimi duhet të kryhet në afat prej 60 ditëve nga data e aprovimit të projektit dhe të gjitha pagesat mbi shumën 500 € duhet të bëhen përmes transferit bankar;
4. Përfituesi duhet të shkojë në Zyrën Komonale ose drejtpërdrejt në Zyrën Komonale Këshilluese dhe të marr dokumentet e nevojshme për të aplikuar;
5. Me përkrahjen e zyrtarit këshillues komunal ose vet përfituesi bën plotësimin e formularit për aplikim dhe siguron dokumentet e nevojshme;
6. Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në Zyrën Komonale për Bujqësi çdo ditë pune nga ora 09:00-15:30;
7. Zyrtari komunal për bujqësi, në bazë të listës së posaçme kontrolluese, verifikon të gjitha dokumentet nëse ato janë në dispozicion dhe të vlefshme;
8. Nëse dokumentet janë në dispozicion dhe të vlefshme, atëherë zyrtari komunal për bujqësi bën pranimin e formularin për aplikimit, e vulosë atë dhe i jep numrin identifikues. Në rast se nuk janë të gjitha dokumentet në dispozicion dhe të vlefshme, atëherë zyrtari e kthen formularin e aplikimit. Është gjithashtu e mundur të pranojë formularin e aplikimit në rastin e dytë, nëse fermeri firmos

deklaratën se ai është në dijeni që nuk janë të gjitha dokumentet në dispozicion dhe të vlefshme;

9. Kur zyrtari komunal për bujqësi konstaton se aplikacioni i plotëson kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në thirrjen për aplikim, formulari për aplikim transferohet tek Njësia për Pagesa për t'u miratuar. Aplikantët e papranueshëm dhe/ose kërkesat e të cilëve janë gjetur të mos jenë në përputhje me dispozitat për aplikim edhe pas kërkesës së bërë për plotësim do të njoftohen dhe transferohen tek Njësia për Pagesa.

VII. Procedurat e përzgjedhjes dhe konfirmimit

1. Sistemi i cili do të përdoret për t'u menaxhuar aplikacionet do të jetë sipas kriterëve të përcaktuara (sistemi i poentimit) nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Informacioni i plotë rreth kriterëve të përgjithshme është i bashkangjitur në materialin informues;
2. Aplikacionet kontrollohen, përzgjidhen dhe vlerësohen nga Njësia e Pagesave brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e fundit të dorëzimit të aplikacionit në kuadër të thirrjes aktuale për aplikim;
3. Pasi që aplikacioni të jetë kontrolluar sa i përket tërësisë, përshtatshmërisë dhe plotësimit të kriterëve të përzgjedhjes, Njësia e Kontrollit e kontrollon/verifikon aplikacionin në terren;
4. Përfituesi do të pranojë një letër njoftuese për miratimin apo një vendim refuzimi të projektit (së bashku me arsyet);
5. Përfituesi duhet menjëherë të informoj Zyrën Komunale për Bujqësi për fillimin e investimeve (përjashtohen rastet për blerje të makinerisë);
6. Përfituesi, pas përfundimit të investimeve duhet të paraqitet në Zyrën Komunale për Bujqësi për ta plotësuar kërkesën për pagesë në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të investimeve.

VIII. Dokumentet e bashkangjitura

- ↪ Projekti investues i cili duhet të përmbajë formën standarde të përmbajtjes së projektit;
- ↪ Një kopje e letërnjoftimit (LNJ) të vlefshme të Republikës së Kosovës (për persona fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për persona juridik), dokumenti i cili provon fuqinë e nënshkrimit në emër të kompanisë;
- ↪ Një kopje e llogarisë bankare të vlefshme (kartela në emër të kompanisë për persona juridik);
- ↪ Kopjen e certifikatës së numrit fiskal (për subjektet juridike);
- ↪ Vërtetimi kadastral mbi sipërfaqen e tokës së punëshme (me përjashtim të të dhënave kadastrale për pyjet, kopshtet, që nuk janë tokë bujqësore) në pronësi, apo një kopje të kontratës e cila vërteton disponueshmërinë e tokës së punëshme të paktën për 3 vitet e ardhshme pas dorëzimit të aplikacionit;
- ↪ Kopja e certifikatës së trajnimit relevant/veçantë (nëse aplikuesi posedon paraprakisht), ose deklaratën e gatishmërinë për të marrë pjesë në trajnime;

↪ Vërtetim/dëshmi mbi përmbushjen e tatimit në pronë.

IX. Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

Drejtoria Komonale të Bujqësisë				
Nga e hëna deri të premten nga ora 09:00-15:30				
Nr.	Komuna	Personi kontaktues;	Telefoni	e-maili
1	Drenas	Halit Bytyqi	044/ 170-772	bujqesia_dr@hotmail.com
2	Fushë Kosovë	Sylejman Shabani	044/ 277-984	sulejmanshabani@hotmail.com
3	Prishtinë	Merita Tolaj	044/ 327-013	mtolaj@hotmail.com
4	Lipjan	Njazi Ibrahim	044/ 111-949	nijazi_ibrahimi@hotmail.com
5	Podujeva	Xhafer Sekiraqa	044/ 185-127	xhafa-345@hotmail.com
6	Shtime	Ejup Ismaili	044/ 201-876	ejup_ismaili@hotmail.com
7	Obiliq	Musli Mjeku	044/ 316-801	mmjeku@hotmail.com
8	Graçanica	Goran Gjorgjeviq	049/ 776-582	Nicic_86@hotmail.com
9	Dragash	Flamur Sylejmani	044/ 622-121	flamursylejmani2@hotmail.com
10	Rahovec	Ilvi Dërguti	044/925-858	n.shala5@hotmail.com
11	Mamushë	Jyksen Topojan	044/ 131-781	ytopoyan@hotmail.com
12	Prizreni	Jakup Kastrati	044/ 113-121	jakup.k@hotmail.com
13	Malishevë	Milaim Morina	044/ 302-523	milaim08@gmail.com
14	Suharekë	Shaqir Kryeziu	049/ 449-381	shaqa63@hotmail.com
15	Gjilan	Medin Zeqiri	044/ 212-484	medinzeqiri@yahoo.com
16	Viti	Fadile Demelezi	044/ 631-027	dile_da@hotmail.com
17	Novo Bërd	Avdi Vllasaliu	044/ 293-331	avdi.vllasaliu@hotmail.com
18	Kamenicë	Bektesh Dermaku	044/ 428-511	bekteshdermaku@hotmail.com
19	Klllokot	Dosta Mesiq	044/ 722-274	dalja-75@hotmail.com
20	Partesh	Verica Milosheviq	044/ 330-616	milosevic_verica@yahoo.com
21	Ranilluk	Vlladimir Stojaniviq	044/ 434-595	vlladastojanovic83@yahoo.com
22	Ferizaj	Bashkim Mani	044/130-493	b-mani@hotmail.com
23	Kaçanik	Zekirja Koxha	044/ 130-047	koxha_zeki@hotmail.com
24	Shtërpc	Fazli Islami	044/ 323 784	fazliislami@hotmail.com
25	Hani i Elezit	Selvet Shreta	044/479-883	besnik.reci@hotmail.com
26	Mitrovicë	Bedri Bajrami	044/ 245-821	bedribajrami_055@yahoo.com
27	Vushtrri	Avdyl Feka	044/ 295-627	avdyl.feka@hotmail.com
28	Skenderaj	Sabit Ferizi	044/ 215-098	sabitferizi@hotmail.com
29	Leposaviq			
30	Zubin Potok			
31	Zveçan			
32	Junik	Ali Gacaferri	044/ 997-169	aligacaferri@hotmail.com

33	Istog	Mujë Osmanaj	044/ 429-698	mujosmanaj@hotmail.com
34	Deçan	Bajram Çekaj	044/ 154-890	bareci_17@hotmail.com
35	Pejë	Mehdi Mula	044/ 165-225	mmulaj@hotmail.com
36	Klinë	Rexhep Rexhepi	044/ 223-165	rexha_61@hotmail.com
37	Gjakovë	Agron Zorra	044/ 350-417	agronz1@hotmail.com